



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.286/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Violeta Husaj Rugova kryesues, Hajriz Hoti dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 03.02.2025, merr këtë:

VE N D I M

Refuzohen të pabazuara ankesa Anr.286/2025, Anr.288/2025 dhe Anr.289/2025 e datës 01.02.2025, të parashtruara nga Subjekti Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025.

A r s y e t i m

Me datë 01.02.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesa nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në të cilën pretendohet se më datë 31.01.2025, kandidati për deputet, Selman Kolgeci nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike të Kosovës (LDK), ka postuar një video në llogarinë e tij në Facebook, të realizuar në hapësirën e brendshme të Palestrës Sportive “13 Qershori” në Suharekë në kundërshtim me dispozitat ligjore duke shfrytëzuar kështu burimet dhe institucionet publike shtetërore për qëllime elektorale dhe përfitim të votave.

Ndërsa në ankesën Anr.288/2025 LVV ka pretenduar se kandidati për deputet, Urim Suka nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike të Kosovës (LDK), ka postuar një video në llogarinë e tij në Tik Tok, të realizuar në hapësirën e brendshme dhe të jashtme të Palestrës Sportive “13 Qershori” në Suharekë në kundërshtim me dispozitat ligjore duke

shfrytëzuar kështu burimet dhe institucionet publike shtetërore për qëllime elektorale dhe përfitim të votave.

Në ankesën Anr.289/2025, LVV ka pretenduar se kandidati për deputet, Ardian Shala nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike të Kosovës (LDK), ka postuar fotografi me tekst shoqërues, në llogarinë e tij në Facebook, të realizuara në hapësirën e brendshme të Palestrës Sportive “13 Qershori” në Suharekë në kundërshtim me dispozitat ligjore duke shfrytëzuar kështu burimet dhe institucionet publike shtetërore për qëllime elektorale dhe përfitim të votave.

Sipas parashtruesit të ankesave pretendohet se të njëjtit me këtë veprim kanë shkelur nenin 36, paragrafi 1 i Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP).

Ankesave ja ka bashkangjitur si provë: Postimet në facebook dhe fotografi të kandidatëve në fjalë. Kërkojnë nga PZAP-i, që duke u mbështetur në bazën ligjore dhe argumentet e lart cekura, të shqiptoj sanksionin me legjislacionin në fuqi.

Në përgjigje në ankesë subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës, LDK, thekson se pretendimet se kandidatëve për deputet nga radhët e LDK-së, në Suharekë, Ardian Shala, Selman Kolgeci dhe Urim Suka se kanë shkelur nenin 36 paragrafi 1 të LZP-së, me rastin e ftesës për pjesëmarrje në tubimin e subjektit të tyre LDK-së se Palestrës Sportive “13 Qershori” në Suharekë nuk qëndron, sepse të njëjtit e kanë pasur pëlqimin për shfrytëzimin e kësaj hapësire për aktivitetet zgjedhore të partisë me datën 31.01.2025, kur edhe është mbajtur tubimi qendror.

Përgjigjes në ankesë i është bashkangjitur si provë, Pëlqimi i lëshuar nga Drejtoria për Kulturë, Rini, Sport dhe Mërgatë.

Fillimisht Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr.01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ka bashkuar ankesat A.nr.132/2025 dhe Anr.133/2025, të paraqitura me datë 23.01.2025, dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët A.nr.132/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankuesit.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

-Ankesat janë të pa bazuara

Paneli me rastin e shikimit të shkresave të lëndës, vlerësoi se ankesa është e pabazuar pasi që nga fotografitë dhe nga linqet e rrjeteve sociale të kandidatëve në fjalë që paraqitësi i ka bashkangjitur si dëshmi ankesave, nuk mund të vërtetohet se nga ana e Subjektit Politik LDK, se është bërë shkelje e nenit 36 paragrafi 1 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e

Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku parashihet se “personi i cili mban pozitë publike i zgjedhur apo i caktuar nuk mund të përdorë atë zyre apo ndonjë nga pasurit e saj me qëllim të përfitimit të votave. Asnjë nga burimet e asnjë institucioni të administratës publike qoftë të nivelit qendror ose lokal ose edhe ndonjë ndërmarrje ne zotërim ose të kontrolluar nga autoritetet qendrore ose lokale nuk mund të shfrytëzohet ose të futen ne mbështetje të ndonjë subjekti politik në zgjedhje”.

Paneli bazuar në pretendimet ankimore dhe në përgjigjen e bashkangjitur nga Subjekti Politik LDK, konstatohet se në të tri rastet bëhet fjalë për hapësirën e brendshme të Palestrës Sportive “13 Qershori” në Suharekë, për të cilën subjekti Politik LDK ka pasur pëlqimin për shfrytëzimin e kësaj hapësire për aktivitetet zgjedhore të subjektit të tyre me datën 31.01.2025, kur edhe është mbajtur tubimi qendror. Subjekti Politik LDK me përgjigje në ankesë ka siguruar edhe pëlqimin e lëshuar nga Drejtoria për Kulturë, Rini, Sport dhe Mërgatë, në Suharekë, dhe me këtë është vërtetuar se kandidatët në fjalë, këto postime i kanë realizuar po atë ditë kur edhe e kishin të lejuar tubimin e mbajtur zgjedhor të subjektit të tyre LDK. Paneli ka gjetur se subjekti politik LDK, në fjalë nuk ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 36 paragrafi 1 i Ligjit NR.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, e cituar si më lartë, siç pretendohet me ankesë.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: “vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa bazuara për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesa dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtruesi i ankesave nuk ka arritur që të vërtetoj se këto veprime paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura të LZP-së apo të Rregullës Zgjedhore Nr.07/2024, dhe si të tilla të njëjtat i refuzoi si të pabazuara.


Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr.286/2025 më datën 03.02.2025

Kryesues i Panelit

Violeta Husaj Rugova



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.